Te grupuara sipas natyres, ato paraqiten si vijon:

| Nr | Emertimi | Vlera historike | Amortizimi akumuluar | Vlera neto kontabile |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Aktive Afategjata Materiale | | | |
| | Toka-Trualli | - | - | - |
| | Ndertesa,struktura,rruge etj | 12,965,488 | (1,577,825) | 11,387,663 |
| | Makineri,pajisje,mjete transporti etj | 5,536 | (1,389) | 4,147 |
| 2 | Inventari | | - | |
| | Materiale | 12,413,281 | - | 12,413,281 |
| | **Shuma** | **25,384,305** | **(1,579,214)** | **23,805,091** |

Trualli i objektit Teci Tiranë, eshte i regjistruar ne ZRPP-ë dhe ka çertifikate pronesie ne emer te "KESH" sh.a. Eshte ne proces marrja e titullit te pronesise nga "PETROL ALBA" sh.a. Nuk eshte perfshire ne procesverbalet e dorezimit dhe per rrjedhim nuk do jete pjese e ketij zmadhimi kapitali.
Ne proces-verbalin e ketij objekti jane konstatuar disa pretendime per demtime te pjeseshme fizike por pa percaktuar vlerat e ketyre demtimeve.Nuk merren parasysh ne llogaritjen e kontributit nga ky objekt.

## 2. Aktivet materiale –Teci *Cërrik*

Objekti Teci Cërrik, eshte marre ne administrim(ruajtje) te shoqerise "PETROL ALBA" sh.a nga "Korparata Elektroenergjitike Shqiptare" sh.a, me proces verbalin e dates 09.11.2011,mbështetur mbi inventarët fizikë, te analizuar në sasi dhe vlera kontabile për çdo njesi inventariale.
Te grupuara sipas natyres, ato paraqiten si vijon:

| Nr | Emertimi | Vlera historike | Amortizimi akumuluar | Vlera neto kontabile |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Aktive Afategjata Materiale | | | |
| | Trualli | - | - | - |
| | Ndertesa,struktura,rruge etj. | 17,444,643 | (3,021,089) | 14,423,554 |
| | Makineri,pajisje,mjete transporti, etj. | 29,500 | (2,065) | 27,435 |
| 2 | Inventari | | - | |
| | Materiale | 4,526,448 | - | 4,526,448 |
| | **Shuma** | **22,000,591** | **(3,023,154)** | **18,977,437** |

Trualli i objektit Teci Tiranë, eshte i regjistruar ne ZRPP-ë dhe ka çertifikate pronesie ne emer te "KESH" sh.a. Ka probleme te mbivendisjes se truallit,eshte ne proces marrja e titullit te pronesise nga "PETROL ALBA" sh.a. Nuk eshte perfshire ne procesverbalet e dorezimit dhe per rrjedhim nuk do jete pjese e ketij zmadhimi kapitali.

## 3. Aktivet materiale –Teci *Kuçovë*

Objekti Teci Kuçovë, eshte marre ne administrim(ruajtje) te shoqerise "PETROL ALBA" sh.a nga "Korparata Elektroenergjitike Shqiptare" sh.a, me proces verbalin e dates 10.11.2011,mbështetur mbi inventarët fizikë, te analizuar në sasi dhe vlera kontabile për çdo njesi inventariale.

Te grupuara sipas natyres, ato paraqiten si vijon:

| Nr | Emertimi | Vlera historike | Amortizimi akumuluar | Vlera neto kontabile |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Aktive Afategjata Materiale | | | |
| | Trualli | - | - | - |
| | Ndertesa,struktura,rruge etj. | 22,977,345 | (1,606,579) | 21,370,766 |
| | Makineri,pajisje,mjete transporti, etj. | - | - | - |
| 2 | Inventari | | - | |
| | Materiale | 6,885,049 | - | 6,885,049 |
| | **Shuma** | **29,862,394** | **(1,606,579)** | **28,255,815** |

Trualli i objektit Teci Kuçovë, eshte i regjistruar ne ZRPP-ë dhe ka çertifikate pronesie ne emer te "PETROL ALBA" sh.a. Nuk eshte perfshire ne procesverbalet e dorezimit dhe per rrjedhim nuk do jete pjese e ketij zmadhimi kapitali.
Ne proces-verbalin e ketij objekti jane konstatuar disa pretendime per demtime te pjeseshme fizike por pa percaktuar vlerat e ketyre demtimeve.Nuk merren parasysh ne llogaritjen e kontributit nga ky objekt.

## 4. Aktivet materiale -Teci Korçë

Objekti Teci Korçë, eshte marre ne administrim(ruajtje) te shoqerise "PETROL ALBA" sh.a nga "Korparata Elektroenergjitike Shqiptare" sh.a, me proces verbalin e dates 09.11.2011,mbështetur mbi inventarët fizikë, te analizuar në sasi dhe vlera kontabile për çdo njesi inventariale.
Te grupuara sipas natyres, ato paraqiten si vijon:

| Nr | Emertimi | Vlera historike | Amortizimi akumuluar | Vlera neto kontabile |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Aktive Afategjata Materiale | | | |
| | Trualli | | - | - |
| | Ndertesa,struktura,rruge etj. | 124,563,277 | (9,099,595) | 115,463,682 |
| | Makineri,pajisje,mjete transporti, etj. | 604,160 | (136,208) | 467,952 |
| 2 | Inventari | | - | |
| | Materiale | 8,204,445 | - | 8,204,445 |
| | **Shuma** | 133,371,882 | (9,235,803) | 124,136,079 |

Trualli i objektit Teci Korçë, eshte i regjistruar ne ZRPP-ë dhe ka çertifikate pronesie ne emer te "KESH" sh.a. Eshte ne proces marrja e titullit te pronesise nga "PETROL ALBA" sh.a. Nuk eshte perfshire ne procesverbalet e dorezimit dhe per rrjedhim nuk do jete pjese e ketij zmadhimi kapitali.

## 5. Aktivet materiale -Teci Maliq

Objekti Teci Maliq, eshte marre ne administrim(ruajtje) te shoqerise "PETROL ALBA" sh.a nga "Korparata Elektroenergjitike Shqiptare" sh.a, me proces verbalin e dates 08.11.2011,mbështetur mbi inventarët fizikë, te analizuar në sasi dhe vlera kontabile për çdo njesi inventariale.
Te grupuara sipas natyres, ato paraqiten si vijon:

| Nr | Emertimi | Vlera historike | Amortizimi akumuluar | Vlera neto kontabile |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Aktive Afategjata Materiale | | | |
| | Trualli | - | - | - |
| | Ndertesa,struktura,rruge etj. | 74,256,467 | (5,341,966) | 68,914,501 |
| | Makineri,pajisje,mjete transporti, etj. | 49,100 | (3,437) | 45,663 |
| 2 | Inventari | | - | |
| | Materiale | 5,089,588 | - | 5,089,588 |
| | **Shuma** | 79,395,155 | (5,345,403) | 74,049,752 |

Trualli i objektit Teci Maliq, eshte i regjistruar ne ZRPP-ë dhe ka çertifikate pronesie ne emer te "KESH" sh.a. Eshte ne proces marrja e titullit te pronesise nga "PETROL ALBA" sh.a. Nuk eshte perfshire ne procesverbalet e dorezimit dhe per rrjedhim nuk do jete pjese e ketij zmadhimi kapitali.

Ne proces-verbalin e ketij objekti jane konstatuar disa pretendime per demtime te pjeseshme fizike gjate demolimeve por pa percaktuar vlerat e ketyre demtimeve.Nuk merren parasysh ne llogaritjen e kontributit nga ky objekt.

## 6. Aktivet materiale -Teci Vlorë

Objekti Teci Vlorë, eshte marre ne administrim(ruajtje) te shoqerise "PETROL ALBA" sh.a nga "Korparata Elektroenergjitike Shqiptare" sh.a, me proces verbalin e dates 11.11.2011,mbështetur mbi inventarët fizikë, te analizuar në sasi dhe vlera kontabile për çdo njesi inventariale.
Te grupuara sipas natyres, ato paraqiten si vijon:

| Nr | Emertimi | Vlera historike | Amortizimi akumuluar | Vlera neto kontabile |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Aktive Afategjata Materiale | | | |
| | Trualli | - | - | - |
| | Ndertesa,struktura,rruge etj. | 47,341,741 | (3,313,921) | 44,027,820 |
| | Makineri,pajisje,mjete transporti, etj. | - | - | - |
| 2 | Inventari | | - | |
| | Materiale | 498,335 | - | 498,335 |
| | Shuma | 47,840,076 | (3,313,921) | 44,526,155 |

Trualli i objektit Teci Vlorë, eshte i regjistruar ne ZRPP-ë dhe ka çertifikate pronesie ne emer te "KESH" sh.a. Kerkohen plotesime ne dokumentacionin teknik,eshte ne proces marrja e titullit te pronesise nga "PETROL ALBA" sh.a. Nuk eshte perfshire ne procesverbalet e dorezimit dhe per rrjedhim nuk do jete pjese e ketij zmadhimi kapitali.

## 7. Aktivet materiale -Teci Fier

Objekti Teci Fier, eshte marre ne administrim(ruajtje) te shoqerise "PETROL ALBA" sh.a nga "Korparata Elektroenergjitike Shqiptare" sh.a, me proces verbalin e dates 14.05.2012, mbështetur mbi inventarët fizikë, te analizuar në sasi dhe vlera kontabile për çdo njesi inventariale.

Te grupuara sipas natyres, ato paraqiten si vijon:

| Nr | Emertimi | Toka-trualli | | Amortizimi akumuluar | Vlera neto kontabile |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Siperfaqe m2 | Vlera historike | | |
| 1 | Aktive Afategjata Materiale | | | | |
| | Trualli | 170,950 | 81,259,200 | - | 81,259,200 |
| | Ndertesa,struktura,rruge etj. | x | 78,676,496 | (50,315,265) | 28,361,231 |
| | Makineri,pajisje,mjete transporti, etj. | x | 1,371,300,300 | (1,161,315,650) | 209,984,650 |
| 2 | Inventari | | | - | |
| | Materiale | x | 156,301,658 | - | 156,301,658 |
| | Lende djegese | x | 19,510,610 | - | 19,510,610 |
| | Skrap(ne magazine) | x | 75,770,500 | - | 75,770,500 |
| | Shuma | 170,950 | 1,782,818,764 | (1,211,630,915) | 571,187,849 |

Trualli i objektit Teci Fier, eshte i pa regjistruar ne ZRPP-ë. Ne baze te VKM-së Nr. 1008, date 30.07.2006, siperfaqja totale e objektit eshte 170.950 m2. Nga shoqeria po hartohet dokumentacioni teknik per rregjistrim e pronesise se tij ne emer te "PETROL ALBA" sh.a.
Vlera kontabile e truallit eshte perfshire ne procesverbalet e dorezimit dhe per kete arsye vlera e tij eshte pjese e ketij zmadhimi kapitali.
Ne proces-verbalin e ketij objekti jane konstatuar disa pretendime per mungesa e demtime te pjeseshme fizike por pa percaktuar vlerat e ketyre demtimeve. Nuk merren parasysh ne llogaritjen e kontributit nga ky objekt.

## Permledhja e kontributeve sipas objekteve dhe të klasifikuara sipas natyres së tyre.

| Nr | Emertimi | Aktive Afatgjata Materiale | | | | Inventari (Vlere kontabile) | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Toke, truall | | Ndertesa,struktura,rruge etj. (Vl.kontabile neto) | Makineri e pajise (Vl.kontabile neto) | | |
| | | Sip. m2 | Vlera | | | | |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | (2+3+4+5) |
| 1 | Teci Tiranë | - | - | 11,387,663 | 4,147 | 12,413,281 | 23,805,091 |
| 2 | Teci Cërrik | - | - | 14,423,554 | 27,435 | 4,526,448 | 18,977,437 |
| 3 | Teci Kuçovë | - | - | 21,370,766 | | 6,885,049 | 28,255,815 |
| 4 | Teci Korçë | - | - | 115,463,682 | 467,952 | 8,204,445 | 124,136,079 |
| 5 | Teci Maliq | - | - | 68,914,501 | 45,663 | 5,089,588 | 74,049,752 |
| 6 | Teci Vlorë | - | - | 44,027,820 | - | 498,335 | 44,526,155 |
| 7 | Teci Fier | 170,950 | 81,259,200 | 28,361,231 | 209,984,650 | 251,582,768 | 571,187,849 |
| | Shuma(1-7) | 170,950 | 81,259,200 | 303,949,217 | 210,529,847 | 289,199,914 | 884,938,178 |
| | Inventar i shitur para ketij zmadhimi | | | | | (34,356,660) | (34,356,660) |
| | Shuma | 170,950 | 81,259,200 | 303,949,217 | 210,529,847 | 254,843,254 | 850,581,518 |

Gjate periudhes që shoqeria "PETROL ALBA" sh.a ka pasur ne administrim aktivet materiale te teceve, nje pjese e inventarit(materiale ne magazine) prej 60,054,938 leke, vleresuar me vleren e percaktuar ne procesverbale, e ka perfshire ne rregjistrat kontabel dhe bilancin e shoqerise duke i konsideruar ato si grande të dhena nga shteti.
Po ne te njejten periudhe eshte realizuar shitja e ketij inventari ne vleren 34,356,660 leke (ne vlere kontabile),me procedura te njejta qe shoqeria perdorte per ativet e saj.

Me miratimin e pasqyrave financiare te vitit 2012,me shkresen Nr.156/1 Prot. date 04.12.2014 e Ministrit te Ministrise se Zhvillimit Ekonomik,Tregtise dhe Sipermarrjes, urdherohet qe shoqeria "PETROL ALBA" sh.a, që lendet e para dhe materilet qe ka shitur nga objektet qe ka patur ne administrim te njihen si detyrime kreditore ndaj shtetit dhe jo si grant, dhe se ky sistemim te kryhet ne pasqyrat financiare te vitit 2013.

Mbeshtetur mbi keto fakte,pas sistemimeve te kryera, vlera kontabilile e prej **34,356,660 leke** qe i perket inventarit te shitur eshte zbritur nga vlera totale e kontributit per arsye se aksionari i vetem ka vendosur ta trajtoje ate se detyrim ndaj shtetit.

**Si perfundim, vlera totale e aktiveve materiale qe perbejne Kontributin ne Natyre te trasferuara tek "PETROL ALBA" sh.a eshte 850.581.518 leke.**

## Perllogaritja e zmadhimit te kapitalit te regjistruar,aksioneve te reja dhe e vleres se tyre

Nga verifikimi i Ekstraktit te Rregjistrit Tregetar te shoqerise "PETROL ALBA" sh.a, ne daten 14.03.2014 rezulton se kapitali i rregjistruar e shoqerise eshte **1.813.683.000 leke** i perbere nga **1.813.683 aksione** me vlere nominale **1.000 leke per çdo aksion**.Aksionet e shoqerise jane te zakonshme dhe kontributet per aksionet e nenshkruara me pare jane shlyer teresisht.
Emetimi i ri i aksioneve duhet te behet me vleren nominale te aksioneve ekzistuese dhe pa prim.

Bazuar ne vleren e konribureve ne natyre të pershkruar me siper, Kapitali i Regjistruar i shoqerise PETROL ALBA" sh.a do te zmadhohet me vleren **850.581.000 leke**, i ndare ne 850.581 aksione te reja me vlere nominale 1.000 leke per aksion dhe perfitohen nga aksionari i vetem i shoqerise.
Vlera e mbetur e kontributit ne natyre per shkak te rrubullakimeve prej 518 leke te kaloje ne rezerva te kapitalit.

Gjendja dhe ndryshimet e kapitalit te regjistruar paraqiten ne tabelen e meposhteme:

| Nr | Emertimi | Aksionari i vetem-Ministria e Zhvillimit Ekonomik,Tregtisë dhe Sipermarrjes | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Aksione | Vlera nominale per aksion | Kapitali regjistruar |
| a | *Kapitali i regjistruar në date 14.03.2014* | 1,813,683 | 1,000 | 1,813,683,000 |
| b | *Zmadhimi i kapitalit-Kontribute në natyrë më 14.03.2014* | 850,581 | 1,000 | 850,581,000 |
| c | *Kapitali i regjistruar pas zmadhimit* | 2,664,264 | 1,000 | 2,664,264,000 |

## Opinion

Në përfundim te verifikimeve qe kemi kryer, arrijme ne konkluzionin se :

- **Aktivet materiale të trasferuara në shoqerine "PETROL ALBA" sh.a nga "Korparata Elektroenergjitike Shqiptare" sh.a, si kontribut ne natyre i Aksionarit te vetem-Ministria e Zhvillimit Ekonomik,Tregtisë dhe Sipermarrjes, ekzistojne dhe jane vleresuar me vlerat e duhura.**
- **Ne perputhje me vleren e llogaritur te kontributeve, Kapitali i Regjistruar i shoqerise "PETROL ALBA" sh.a do te zmadhohet me vleren 850.581.000 leke, i ndare ne 850.581 aksione te reja me vlere nominale 1.000 leke per aksion dhe perfitohen nga tëresisht nga aksionari i vetem.**

**AS-Audit Services sh.p.k**

**Ekspert Kontabel i Regjistruar**

**Afrim Suli**

Liçenca profesionale
Nr.4, date 11. 01.2000

14 Mars 2014

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Audit Services sh.p.k

MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT

# URDHËR

*Nr 4474/1, Datë 15. 6. 2015*

*"Për zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë "PETROL ALBA" SHA në likuidim"*

Bazuar në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve në shoqëri tregtare", ndryshuar me akte te tjera ligjore dhe të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me cilësinë e aksionarit të vetëm:

**URDHËROJ:**

1. Kapitali themeltar i shoqërisë SHA "PETROL ALBA", Tiranë në likuidim, të zmadhohet me objektin "Pikë e Shpërndarjes me Pakicë të Karburanteve, Tepelenë" për vlerën 2,921,000 lekë e barabartë me 2,921 aksione me vlerë nominal 1000 lekë secili .
2. Kapitali themeltar i SHA "PETROL ALBA", Tiranë në likuidim, të bëhet nga 2,664,264,000 lekë në 2,667,185,000 lekë e barabartë me 2,667,185 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secili.
3. Ngarkohet likuidatori i shoqërisë, për kryerjen e veprimeve përkatëse në përputhje me parashikimet e Ligjit 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", seksioni III.
4. Ngarkohet shoqëria për zbatimin e këtij urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**ARBEN AHMETAJ**

**MINISTËR**

AS-Audit Services sh.p.k
Rr. "KOSOVAREVE", ND.35, H.2, Ap.7 Njesia Bashkiake Nr.5
Kodi Postar 1019
Cel: 069 20 99 204
Tel/fax: (04) 2 430 084
E-mail: as-auditservices@hotmail.com

# Raport i ekspertit kontabël për zmadhimin e kapitalit me kontribute në natyrë, të shoqërisë "PETROL ALBA" sh.a (shoqëri në likujdim e sipër)

Drejtuar: Aksionerit të shoqërisë "PETROL ALBA" Sh.a
Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik,Tregtisë dhe Sipërmarrjes

I nderuar z.Ministër,

Unë Afrim Suli, Ekspert Kontabël i Regjistruar, mbajtës i liçences profesionale nr.4, date 11.01.2000, me urdherin Nr.79 date 30.01.2014 te Ministrit te Ministrise se Zhvillimit Ekonomik,Tregtise dhe Sipermarrjes, jam caktuar me cilesine ekspertit te autorizuar per zmadhimin e kapitalit te shoqerise "PETROL ALBA" sh.a me kontribute në natyre.

## Qëllimi angazhimit

Qellimi i angazhimit eshte qe në perputhje me ligjin "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", neni 169, te verifikoj vleren e kobntributeve në natyrë që aksionari i vetem-Ministria e Zhvillimit Ekonomik,Tregtisë dhe Sipermarrjes(MZHETS), do të trasferojë në shoqerine "PETROL ALBA" sh.a, ne kembim te marrjes aksioneve te reja te emetuara ne procesin e zmadhimit te kapitalit.

Pra ai konsiston ne verifikimin e aktiveve materiale(Troje,ndertesa,makineri,pajisje,inventar etj) qe do te merren në aktivet e shoqerise "PETROL ALBA" sh.a, nga pikëpamja e ekzistences, pronesise, vleresimit të drejte, si dhe perllogaritjen e numrit dhe vleres se aksioneve te reja qe duhet emetohen në perputhje me vleren e kontributeve.

## Baza ligjore dhe burimet e informacionit

Baza ligjore mbi të cilën mbeshtetet raporti:

- Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare";
- Urdheri Nr.79 date 30.01.2014 i Ministrit te Ministrise se Zhvillimit Ekonomik,Tregtise dhe Sipermarrjes, i ndryshuar, që urdheron kalimin ne pronesi të "PETROL ALBA" sh.a, te objekteve te listuara pas urdherit, te cilat jane kontribute në natyre te aksionarit te vetem te shoqerise, per zmadhimin e kapitalit te regjistruar;
- Legjistacioni kontabel dhe ai i privatizimeve te prones shteterore.



REPUBLIKA E SHQIPERISE AS-Audit Services sh.p.k.

Ne pregatitjen e Raportit u perdoren keto burime:

- Raporti i vleresimit te prones,date 20 Maj 2015, i pergatitur nga ekspertja vleresuese e shkalles se pare, Ing.Elvira Serjanaj, emeruar me Urdheri Nr.79 date 30.01.2014 i Ministrit te Ministrise se Zhvillimit Ekonomik,Tregtise dhe Sipermarrjes.
- Çertifikatat e rregjistrimit te pasurise(Vertetim nga dokumente hipotekore), leshuar nga ZRPP e rrethit Tepelene më date 30.04.2015.
- Ekstrati "Gjendja e regjistrit fillestar" publikuar nga QKR të datës 12.02.2014.
- Te tjera informacione te vlefshme.

## Përshkrim i shkurtër i shoqërisë dhe veprimtarisë së saj

Shoqeria tregtare "PETROL ALBA" sh.a, eshte e themeluar si person juridik me 06 Qershor 2008, ne formen ligjore "shoqeri aksionare" dhe indentifikohet ne regjistrin tregetar me NIPT-in K81706017T. Kapitali i rregjistruar i saj ne daten e hartimit te ketij raporti, eshte **2.664.264.000** leke i ndare ne **2.664.264 aksione** aksione me vlere nominale 1.000 leke per aksion dhe zoterohet teresisht nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik,Tregtisë dhe Sipermarrjes.
Me urdher te aksionarit te vetem Nr.975 date 01.12.2011, eshte vendosur për prishjen e shoqerise dhe shpalljen e saj ne likujdim dhe aktualisht vazhdon te jete me status "shoqeri ne likujdim e siper".

Si shoqeri ne likujdim, objekti normal i veprimtarise se saj është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve.

Por dhe pse eshte ne likujdim,shoqeria ne periudha te ndryshme, me urdher te aksionarit te vetem, ka marre ne pronesi nga entitete te tjera tregtare me aksionar shtetin, aktive materiale si, ndertesa, makineri, pajisje, inventar etj, ne formen e kontributeve ne natyre per zmadhimin kapitalit te regjistruar te shoqerise nga aksionari i vetem i saj. E kesaj natyre eshte dhe zmadhimi i kapitalit qe paraqitet ne kete raport.

## Përshkrimi i aktiveve materiale që do vendosen si kontribute në natyrë.

Në urdherin e Ministrit te MZHETS-se, Nr.79 date 30.01.2014, i ndryshuar, eshte urdheruar per te kaluar ne pronesi te shoqerise "PETROL ALBA" sh.a aktivet materiale te listuara si me poshte vijon:

- Tecet, Tirane, Cërrik, Kuçove, Korçë, Maliq, Vlore dhe Fier,
- Pikat e shperndarjes me pakice te karburanteve, ne Korçe, Bilisht, Tepelene, Laprake, Peshkopi-Vlore, Kam dhe Erseke.
- Objekte te tjera, si Depozitat Prrenjas, Depo e gazit te lengshem-Ballsh, Reparti Briketimit-Ballsh dhe Magazinat e Depozitimit-Kavaje.

Per shkak te veshtiresive qe kishte pergatitja e dokumentacionit dhe marrja ne zoterim te shoqerise e te gjitha objekteve te percaktuara në të njejten kohe, me kerkesen e drejtimit te shoqerise eshte rene dakort që procesi te realizohej ne disa faza, ne varesi të kompletimit te dokumentacionit të nevojshem.

Ne fazen e pare jane kaluar ne pronesi te shoqerise aktivet e shtatë objekteve te listes qe u perkisnin teceve, ndersa ne kete faze do te kaloje **"Pika e shperndarjes me pakice te karburanteve,Tepelene".**

**Objekti "Pika e shperndarjes me pakice te karburanteve,Tepelene"** ndodhet ne qytetin e Tepelenes, ne zonen kadastrale nr.3574, me numer pasurie 3/32, siperfaqe trualli prej 2.540 m² dhe siperfaqe nderimi 10,1 m².
Perveç nderteses, mbi truall ekzistojne të vendosura gjithashtu dhe ndertime te tjera si struktura metalike,depo etj, te cilat kane qene objekt vleresimi nga ekspertet vleresues dhe jane pjese e kontributit ne natyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AS - Audit Services sh.p.k

Kontributet qe jane pasuri e paluejteshme, trualli dhe ndertimet mbi trual, jane kaluar në pronesi të "PETROL ALBA" sh.a, në regjistrin hipotekar nr.18 date 22.04.2015 dhe vertetohet me dokumentin "Vertetim nga dokumente hipotekore", leshuar nga ZRPP e Rrethit Tepelene më date 30.04.2015.
Perveç ketij dokumenti qe perben dhe aktin e marrjes ne dorezim te inventarit fizik te aktiveve afatgjata materiale, shoqeria nuk disponon dokumenta për gjendje të tjera fizike inventari ne objekt.

## Metoda e vleresimit të kontributit në natyrë.

Ne perputhje me nenin 112 të ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", kur aksionarët japin kontribute në natyrë, këto kontribute duhet të vlerësohen nga ekspertë, persona fizikë apo juridikë të licencuar, me kompetenca teknike të nevojshme për kryerjen e këtyre vlerësimeve.
Ne baze te urdherit Nr.79 date 30.01.2014 të Ministrit te Ministrise se Zhvillimit Ekonomik,Tregtise dhe Sipermarrjes, ky vleresim eshte kryer nga ekspertja vleresuese e shkalles se pare, Ing.Elvira Serjanaj, me raportin e vleresimit të datës 20 Maj 2015, te cilin e gjeni bashkangjitur.

Raporti i vlerësimit përmban një përshkrim të hollësishëm të kontributeve në natyrë, si dhe të metodave të vlerësimit që janë zbatuar për të llogaritur *vleren e tregut* të ketyre pasurive.

Sipas Manualit të Standarteve Europiane te Vleresimit vlera e tregut perkufizohet:

*"Vlera e tregut, eshte shuma e vleresuar me te cilen nje pasuri do të shkembehej në datën e vleresimit midis nje bleresi dhe shitesi te vullnetshem,ne nje transaksion ku palet nuk kane lidhje me njera tjetren, pasi te jete bere marketingu i duhur dhe palet kane vepruar me dijeni kujdes dhe pa detyrim"*

## Vlera e kontributeve natyrë

"Pika e shperndarjes me pakice te karburanteve",Tepelenë", bazuar ne raportin e vleresimit te ekspertes vleresuese rezulton të jete si me poshte:

| Nr | Emertimi | Aktivet Afatgjata Materiale | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Njesia e | Sasia | Vlera tregut |
| | Aktive Afategjata Materiale | | | |
| 1 | Trualli gjithsej | $m^2$ | 2,540 | 2,024,380 |
| 2 | Ndertesa | $m^2$ | 10.1 | 232,080 |
| 3 | Struktura metalike | x | x | 180,330 |
| 4 | Depo,tenda. | x | x | 484,777 |
| | Shuma | x | x | 2,921,567 |

**Si perfundim, vlera totale e aktiveve materiale qe perbejne Kontributin ne Natyre te aksionarit, të trasferuara tek "PETROL ALBA" sh.a eshte, 2.921.567 leke.**

## Perllogaritja e zmadhimit te kapitalit te regjistruar,aksioneve te reja dhe e vleres se tyre

Nga verifikimi i Ekstraktit te Rregjistrit Tregetar te shoqerise "PETROL ALBA" sh.a, ne daten 01.06.2015 rezulton se kapitali i rregjistruar e shoqerise eshte **2.664.264.000leke** i perbere nga **2.664.264 aksione** me vlere nominale **1.000 leke per çdo aksion**.Aksionet e shoqerise jane te zakonshme dhe kontributet per aksionet e nenshkruara me pare jane shlyer teresisht.
Emetimi i ri i aksioneve duhet te behet me vleren nominale te aksioneve ekzistuese dhe pa prim.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AS - Audit Services sh.p.k.

Bazuar ne vleren e konribureve ne natyre të pershkruar me siper, Kapitali i Regjistruar i shoqerise "PETROL ALBA" sh.a do te zmadhohet me vleren **2.921.000 leke**, i ndare ne **2.921 aksione** te reja me vlere nominale 1.000 leke per aksion dhe perfitohen nga aksionari i vetem i shoqerise.
Vlera e mbetur e kontributit ne natyre per shkak te rrubullakimeve prej 567 leke te kaloje ne rezerva te kapitalit.

Gjendja dhe ndryshimet e kapitalit te regjistruar paraqiten ne tabelen e meposhteme:

| Nr | Emertimi | Aksionari i vetem-Ministria e Zhvillimit Ekonomik,Tregtisë dhe Sipermarrjes | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Aksione | Vlera nominale per aksion | Kapitali regjistruar |
| a | *Kapitali i regjistruar në date 01.06.2015* | 2,664,264 | 1,000 | 2,664,264,000 |
| b | *Zmadhimi i kapitalit-Kontribute në natyrë më 01.01.2015* | 2,921 | 1,000 | 2,921,000 |
| c | *Kapitali i regjistruar pas zmadhimit* | 2,667,185 | 1,000 | 2,667,185,000 |

## Opinion

Në përfundim te verifikimeve qe kemi kryer, arrijme ne konkluzionin se :

- **Aktivet materiale të trasferuara në shoqerine "PETROL ALBA" sh.a nga "Pika e shitjes me pakice te karburanteve,Tepelene", si kontribut ne natyre i Aksionarit te vetem-Ministria e Zhvillimit Ekonomik,Tregtisë dhe Sipermarrjes, ekzistojne, jane kaluar ne pronesi të shoqerise dhe jane vleresuar me vlerat e duhura.**
- **Ne perputhje me vleren e llogaritur te kontributeve, Kapitali i Regjistruar i shoqerise "PETROL ALBA" sh.a do te zmadhohet me vleren 2.921.000 leke, i ndare ne 2.921 aksione te reja, me vlerë nominale 1.000 lekë për aksion dhe përfitohen nga tëresisht nga aksionari i vetem.**

Shenim:Bashkangjitur raportit do të gjeni informacionin baze mbeshtetes: Raporti i Vleresimit, çertifikatat e rregjistrimit te pasurise(Vertetim nga dokumente hipotekore)

**AS-Audit Services sh.p.k**

**Ekspert Kontabel i Regjistruar**

**Afrim Suli**

REPUBLIKA E SHQIPERISE AS Audit Services sh.p.k.

**01 Qershor 2015**

No. 54/4 Prot.
Dt. 14.07.2015

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

# URDHËR

**Nr.3632/14 Datë 13.7.2015**

**PËR**

**ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SH.A "PETROL ALBA" TIRANË**

**Drejtuar: SH.A "PETROL ALBA" TIRANË**

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Urdhrit të MZHETTS Nr. 3632, datë 5.5.2015, me cilësinë e aksionarit të vetëm të Sh.a " Petrol alba" Tiranë,

**URDHËROJ:**

1. Kapitali themeltar të zmadhohet për vlerën 8 196 000 lekë, i barabartë me 8 196 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila, që i përket vlerës kontabile të HEC-eve të vegjël të transferuara nga sh.a "KESH" Tiranë.
2. Kapitali Themeltar i shoqërisë bëhet 2 675 381 000 lekë, i barabartë me 2 675 381 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
3. Këto ndryshime të bëhen në aktet e themelimit të shoqërisë.
4. Bazuar në Ligjin 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ngarkohet Drejtoria e shoqërisë " Petrol alba" Tiranë për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**ARBEN AHMETAJ**

"PETROL ALBA" Sh.a.
(Shoqeri ne likujdim)

## RAPORTI I DHENIES SE SIGURISE I EKSPERTIT KONTABEL TE REGJISTRUAR

Mbi Pasqyren Financiare te Kapitalit te Regjistruar dhe
Pasqyra llogaritjeve te kuotave te kapitalit
per qellim te zmadhimit te Kapitalit te Regjistruar.

**Permbajtja:** **Faqe**


RAPORT I DHENIES SIGURISE I AUDITUESIT TE PAVARUR.....1

PASQYRA FINANCIARE E KAPITALIT TE REGJISTRUAR me **18.06.2015**. .....3

PASQYRA E LEVIZJES PER EFEKTE TE ZMADHIMIT TE KAPITALIT TE REGJISTRUAR.....3

PASQYRA PER LLOGARITJEN E AKSIONEVE PAS ZMADHIMIT TE KAPITALIT.....3

PASQYRA PER LLOGARITJEN E AKSIONEVE SIPAS AKSIONEREVE PAS ZMADHIMIT TE KAPITALIT.....3

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE PER QELLIM TE ZMADHIMIT TE KAPITALIT TE REGJISTRUAR.....4

TABELA E HEC-VE TE VEGJEL.....6

**RAPORT I DHENIES SIGURISE I AUDITUESIT TE PAVARUR**

**Drejtuar:** **ASAMBLESE SE AKSIONEREVE TE SHOQERISE "PETROL ALBA" sh.a.**

**Adresa:** **Bulevardi Gjergj Fishta,ish "N.P.V Ushtria",**
**Tirane , Shqiperi**

**Qellimi i Angazhimit:**
Asambleja e aksionereve te shoqerise me vendimin **Nr 3632 Date 05/05/2015** me ka angazhuar si ekspert kontabel te regjistruar per te verifikuar dhe për të dhene siguri te arsyeshme mbi përgatitjen dhe paraqitjen me vërtetësi të shumave të zmadhimit të kapitalit te regjistruar, nepermjet kontributeve ne natyre qe aksioneri i vetem Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Sipermarrjes (MZHETS) do te transferoje ne shoqerine "Petrol Alba" sha, ne kembim te marrjes se aksioneve te reja te emetuara ne procesin e zmadhimit te kapitalit .

**Kriteret**
Si baze per angazhimin e verifikimit të zmadhimit të kapitalit te regjistruar, ne kemi perdorur Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, Ligjin Nr.9228 date 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" (te ndryshuar) dhe Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
Ne jemi njohur dhe kemi verifikuar edhe Vendimin e asamblese te shoqerise me **Nr 3632 Date 05/05/2015** per zmadhimin e kapitalit nepermjet kontributit ne natyre me vlerat e Hec-ve te vegjel te transferuara nga KESH sha tek Petrol Alba sha.

**Pergjegjesia e Drejtimit**
Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në përputhje me kriteret e sipërpërmendura. Kjo përgjegjësi përfshin: përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabile; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabile të arsyeshme për rrethanat financiare.

**Pergjegjesia jonë**
Pergjegjesia jone eshte qe, bazuar ne procedurat e kryera, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra finaciare.
**Ne e kryem auditimin ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Angazhimeve te Dhenies se Sigurise (SNAS 3000) "Angazhimet te Dhenies se Sigurise qe ndryshojne nga Auditimet apo rishikimet e Informacioneve Financiare Historike"** dhe standardet e tjera që lidhen me çështjen në fjalë. Keto standarde kerkojne qe ne te planifikojme dhe te kryejme procedurat e nevojshme per te siguruar nje nivel sigurie te arsyeshme qe informacionet të përgatitura nga drejtimi i shoqërisë për kapitalin e regjistruar jane të vërteta dhe të sinqerta, ne te gjitha aspekte materiale, si dhe kontributet ne natyre e aksionerit te vetem te shoqerise mund te perdoren per qellim te zmadhimit te kapitalit te shoqerise.

**Procedurat e kryera nga ana jone per këtë angazhim perfshijne:**
1. Verifikimin e perputhshmerise se shifrave te pasqyres se Kapitalit te Regjistruar, me ato te pasqyrave financiare te vitit ushtrimor te mbyllur me **18 Qershor 2015.**
2. Verifikimin e vlerave te kontributeve ne natyre qe do te perdoren per zmadhimin e kapitalit te regjistruar.
3. Verifikimin e llogaritjeve per numrin e kuotave si efekt te zmadhimit te kapitalit te regjistruar.
4. Perputhshmerine e vendimit te asamblese me aktet ligjore dhe statutore te shoqerise.

**Konkluzioni**

1. Per mendimin tone, bazuar ne procedurat e kryera, Kapitali i Regjistruar per periudhen e mbyllur **18.06.2015** eshte **2,667,185,000 leke**
   Kjo shume rakordon me llogarine përkatëse dhe dokumentacionin mbështetës që ne verifikuam dhe jep nje pasqyrim të sinqertë dhe te vertete te kapitalit te regjistruar, per periudhen e mbyllur me **18 Qershor 2015**.
2. Vlera e kontributit ne natyre prej **8,196,000** leke qe eshte perdorur per zmadhimin e kapitalit te regjistruar te shoqerise Petro Alba sh.a. jane te besueshme ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit dhe me dokumentacionin perkates qe zoteron shoqeria.
3. Llogaritjet e bera për të përcaktuar numrin e aksioneve shtesë në kapital, për **8,196** aksione me vlere nominale **1,000** leke secila, pasqyrojne me vertetesi raportin e kembimit, te vleres se kontributeve ne natyre e cila perbehet nga vlera kontabel neto e Hec-ve te vegjel te transferuara nga KESH sha tek Petrol Alba sha, ne kapitalin e regjistruar te shoqerise.
4. Vendimi i zmadhimit të kapitalit te regjistruar nga ana e asamblese se aksionereve dhe dokumentat që e mbështesin atë vendim janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe statutore të Shoqërisë Petro Alba sha.

**OPINIONI**

Sipas opinionit tone, pasqyrat e hartuara nga shoqeria **PETROL ALBA sha**, per zmadhimin e kapitalit te regjistruar nepermjet vleres se kontributeve ne natyre e cila perbehet nga vlera kontabel neto e Hec-ve te vegjel te marra nga aksioneri i vetem i shoqerise Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Sipermarrjes ne shumen prej **8,196,000** leke, japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte ne te gjitha aspektet materiale, bazuar ne Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, Ligjin Nr.9228 date 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" (te ndryshuar) dhe Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

ELTON MERSINI
Ekspert Kontabel i Autorizuar
NIPT K33322201U
ELBASAN
Lic. Prof. Nr. 170 Dt. 21.09.2007
Mobile: ++355 (0) 692056750

**Elton MERSINI**
***Ekspert Kontabel i Regjistruar***

***Date 29.06.2015***

## 1- PASQYRA FINANCIARE E KAPITALIT TE REGJISTRUAR me 18.06.2015.

| KAPITALI I REGJISTRUAR | 01.01.2015 -18.06.2015 |
|---|---|
| Kapitali i regjistruar 01.01.2015 | 2,664,264,000 |
| Rritje kapitali me 17.06.2015 | + 2,921,000 |
| **KAPITALI I REGJISTRUAR 18.05.2015** | **2,667,185,000** |

## 2- PASQYRA E LEVIZJES PER EFEKTE TE ZMADHIMIT TE KAPITALIT TE REGJISTRUAR.

Aksioneri ka vendosur qe te zmadhoje kapitalin e regjistruar te shoqerise me vleren kontable neto te Hec-ve te vegjel te transferuara nga KESH sh.a. te cilat pasqyrohet ne pasqyren e meposhtme:

| EMERTIMI | Njesia | ISHTE | Shtesat(+) /Pakesimet(-) | BEHET |
|---|---|---|---|---|
| Kapitali I Regjistruar | leke | 2,667,185,000 | +8,196,000 | 2,675,381,000 |

## 3- PASQYRA PER LLOGARITJEN E AKSIONEVE PAS ZMADHIMIT TE KAPITALIT.

| EMERTIMI | Njesia | ISHTE | Shtesat(+) /Pakesimet(-) | BEHET |
|---|---|---|---|---|
| Kapitali themeltar | leke | 2,667,185,000 | **+8,196,000** | **2,675,381,000** |
| Vlera Nominale | leke/aksion | 1,000 | - | 1,000 |
| **Aksione** | aksione | **2,667,185** | **+8,196** | **2,675,381** |

## 4- PASQYRA PER LLOGARITJEN E AKSIONEVE SIPAS AKSIONEREVE PAS ZMADHIMIT TE KAPITALIT.

| AKSIONERET | ISHTE | | Shtesat(+) /Pakesimet(-) | | BEHET | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | (%) | (Aksione) | (%) | (Aksione) | % | (Aksione) |
| Ministria Zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Sipermarrjes | 100% | 2,667,185 | - | **+8,196** | 100% | 2,675,381 |
| **TOTALI** | **100%** | **2,667,185** | **-** | **+8,196** | **100%** | **2,675,381** |

**Perfaqesuesi Ligjor**
**Artan GJOKAJ**
**Date 18.06.2015**

**SHENIME MBI PASQYRAT FINACIARE PER QELLIM TE ZMADHIMIT TE KAPITALIT TE REGJISTRUAR**

**1. Te dhena te Pergjithshme mbi Shoqerine**

Shoqeria Petrol Alba sh.a., eshte themeluar si person jurudik me 06.06.2008, ne formen e ligjore "shoqeri aksionere" dhe indetifikohet ne rregjistrin tregetar me NIPT-in K81706017T. Kapitali i regjistruar i saj aktualisht eshte **2,667,185,000** leke i ndare ne **2,667,185** aksione me vlere nominale **1,000** leke/aksion.
**Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Sipermarrjes (MZHETS) zoteron 100% te aksioneve te shoqerise Petrol Alba sh.a.**
Me urdher te aksionerit te vetem nr 975 date 01.12.2011 eshte vendosur per prishjen e shoqerise dhe shpalljen e saj ne likujdim.
Aktualisht objekti i veprimtarise se saj eshte mbyllja e te gjitha veprimtarive te shoqerise, mbledhja e debive te paarketuara, shitja e pasurise se shoqerise dhe shlyerja e kreditoreve.

**2. Te Dhena Per Zmadhimin e Kapitalit te Regjistruar.**

Aksioneri i Vetem i shoqerise **"Petrol Alba" sh.a** me qellim realizimin e objektit te aktivitetit te shoqerise, te permiresimit te struktures se bilancit te shoqerise dhe permiresimit te treguesve te saj ekonomike kane vendosur te zmadhoje kapitalin e regjistruar te shoqerise nga **2,667,185,000** leke ne **2,675,381,000** leke.
Si burim per zmadhimin e kapitalit te regjistruar do te perdoret vlera kontabel neto e Hec-ve te vegjel qe transferohen nga KESH sha, ne shumen prej **8,196,000** leke.
Per kete qellim Aksioneri i Vetem i shoqerise "Petrol Alba" sh.a., MZHETS ka marre vendimin per zmadhimin e kapitalit te regjistruar me **Nr 3632 Date 05/05/2015**.
Per llogaritjen e vleres se kontributit ne natyre nga MZHETS per rritjen e kapitalit te regjistruar, ne vleren prej **8,196,000** eshte marre vlera kontabel neto te HEC-ve te vegjel ne rregjistrat kontabel te KESH sha, shoqeri nga e cila u transferuan keto Hec-e sipas shkreses Nr 4828/1 Date 08.06.2015

**3. Politikat Kontabel per pergatitjen e Pasqyrat Financiare per zmadhimin e Kapitalit te Regjistruar.**

Ne vijim po paraqesim ato pjese te politikave kontabel qe ka zbatuar shoqeria per pregatitjen e pasqyrave financiare qe lidhen drejtpersedrejti apo terthorazi me kapitalin e regjistruar.

**3.1 Baza e pregatitjese se Pasqyrave Financiare**

**a. Menyra e Pregatitjes se Pasqyrave Financiare**
Pasqyrat Financiare te shoqerise jane pregatitur ne te gjitha aspektet e tyre materiale, ne perputhje me Ligjin Nr.9228 date 29.04.2004 dhe Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te shpallura date 15.06.2006.

**b. Monedha Funksionale dhe me te cilen paraqiten pasqyrat**
Pasqyrat Financiare paraqiten ne monedhen vendase Lek (ALL), e cila eshte monedha funksionale dhe raportuese e shoqerise. Informacioni financiar eshte paraqitur ne Leke.

**c. Vlerësime dhe gjykime**
Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në proçesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të kapitalit te regjistruar dhe te aktiveve te marra nga shoqeria. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të ketyre vlerësimeve.
Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

**d. Metodat e vleresimit te elementeve te kontributit ne natyre.**

Duke qene se zmadhimi i kapitalit te regjistruar po behet me kontribute ne natyre nga ana e aksionerit te vetem te shoqerise, ne zbatim te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Standarteve Kombetare te Kontabilitet, eshte e rendesishme qe elementet perberes te kontributit ne natyre nga aksioneri te analizohen:

1- Nese permbushim kerkesat e njohjes se aktivit,

2- Kostoja e ketyre aktiveve mund te percaktohet besueshmerisht,

ne menyre qe keto elemente te njihen si aktive ne pasqyren e pozicionit financiar.

1- Per njohjen e nje aktivi sipas SKK duhet te permbushen dy kushte:

a) te kontrollohet nga shoqeria nepermjet nje ngjarje qe ka ndodhur dhe

b) nga perdorimi i tyre priten perfitime te ardhshme.

a) Hec-et e vegjel kontrollohen nga shoqeria Petrol Alba sha, pasi me urdher nr 3632 date 05.05.2015 te MZHETS eshte bere transferimi i tyre nga KESH sha dhe me shkresen nr 61/1 date 10.06.2015 jane marre ne dorezim nga Petrol Alba sha.

b) Petrol Alba sha duke qene nje shoqeri ne likujdim, Hec-et e vegjel do ti nenshtrohen shitjes se tyre duke krijuar perfitime per shoqerine ne te ardhmen, pasi vlera neto kontabel e tyre eshte e ulet per shkak te amortizimit te tyre.

2- Kostoja e aktiveve te transferuara nga KESH sha te Petrol Alba sha duhet te vleresohet me vleren e drejte te tyre por meqenese ky vleresim kerkon kohe dhe do te kryhet ne nje moment tjeter te mevonshem atehere ne vleresimin e kostos se tyre, vlera me besueshme eshte vlera kontabel neto e ketyre aktive qe kane patur ne regjistrat kontabel te KESH-it nga e cila eshte bere transferimi i ketyre aktiveve.

**HEC-et e vegjel per te cilat vlera kontabel neto eshte zero, nuk mund te njihen si aktive ne pasqyren e pozicionit financiar pasi kostoja e tyre nuk mund te percaktohet me besueshmeri pasi per to duhet patjeter te vleresohen me vleren e drejte te tyre.**
**Per HEC-et me vlere kontabel neto zero do te njihen si aktive te kushtezuara dhe do te jepen sqarime ne shenimet shpejguese te cilat shoqerojne pasqyrat financiare te shoqerise.**

**Hec-et e vegjel te cilat kane nje vlere kontabel neto te ndryshme nga zero, do te njihen si aktive ne pasqyren e pozicionit financiar. Vlera totale e tyre perben vleren me te cilen eshte kryer zmadhimi i kapitalit te regjistruar te shoqerise Pertrol Alba sha.**

Bashkelidhur eshte tabela me HEC-et e vegjel.

**KONKLUZION**

***Vlera totale e aktiveve qe perbejne kontributin ne natyre te transferuara tek Petrol Alba sha eshte 8,196,000 leke***

**Perfaqesuesi Ligjor**
**Artan GJOKAJ**
**Date 18.06.2015**

| Hec e Vegjel qe do te njihen si aktive ne Pasqyren e Bilancit | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr | Emertimi | Rrethi | Vlera kontabel neto | | | | |
| | | | Toka | Ndertesa | Instalime | Makineri Paisje | Totali |
| 1 | HEC Picar | Gjirokaster | 0 | 1,570,549 | 0 | 0 | 1,570,549 |
| 2 | HEC Libohove | Gjirokaster | 0 | 1,163,258 | 0 | 0 | 1,163,258 |
| 3 | HEC Flet | Shkoder | 0 | 1,084,806 | 0 | 0 | 1,084,806 |
| 4 | HEC Kaparjel | Gjirokaster | 0 | 840,638 | 0 | 0 | 840,638 |
| 5 | HEC Hormove | Gjirokaster | 292,000 | 495,200 | 12,240 | 0 | 799,440 |
| 6 | HEC Cini | Gjirokaster | 0 | 506,344 | 0 | 0 | 506,344 |
| 7 | HEC Erind | Gjirokaster | 0 | 466,852 | 0 | 0 | 466,852 |
| 8 | HEC Kolonje | Gjirokaster | 0 | 289,347 | 0 | 0 | 289,347 |
| 9 | HEC Kelcyre | Kukes | 0 | 227,524 | 0 | 0 | 227,524 |
| 10 | HEC Dragobi | Kukes | 0 | 227,524 | 0 | 0 | 227,524 |
| 11 | HEC Cerem | Kukes | 0 | 227,524 | 0 | 0 | 227,524 |
| 12 | HEC Bradoshnice | Kukes | 0 | 227,524 | 0 | 0 | 227,524 |
| 13 | HEC Valbone | Kukes | 0 | 227,524 | 0 | 0 | 227,524 |
| 14 | HEC Curraj Siperm | Kukes | 0 | 227,480 | 0 | 0 | 227,480 |
| 15 | HEC Gjinar | Elbasan | 0 | 0 | 46,510 | 0 | 46,510 |
| 16 | HEC Kallaver | Diber | 0 | 38,746 | 0 | 1,492 | 40,238 |
| 17 | HEC Dardhe | Korce | 0 | 0 | 0 | 22,918 | 22,918 |
| | Totali | | **292,000** | **38,870,884** | **58,750** | **31,074,454** | **8,196,000** |

| Hec e Vegjel qe do te jepen sqarime ne Shenimet shpejguese | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr | Emertimi | Rrethi | Vlera kontabel neto | | | | |
| | | | Toka | Ndertesa | Instalime | Makineri Paisje | Totali |
| 18 | HEC Lukove | Gjirokaster | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 19 | HEC Fterre | Gjirokaster | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 20 | HEC Qarishte | Elbasan | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 21 | HEC Stravaj | Elbasan | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 22 | HEC Gjorice | Bulqize | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 23 | HEC Laç Bruç | Burrel | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 24 | HEC Kumbull | Mirdite | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 25 | HEC Vinjoll | Kurbin | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 26 | HEC Potgozhan | Pogradec | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 27 | HEC Miras | Devoll | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 28 | HEC Menkulas | Devoll | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 29 | HEC Zicisht | Devoll | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 30 | HEC Hocisht | Devoll | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 31 | HEC Kozel | Kolonje | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Totali | | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |

Perfaqesuesi Ligjor
Artan GJOKAJ
Date 18.06.2015

No. 20/3.3.016

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

# URDHËR

*Nr 609/1 Datë 3.2.2016*

*"Për zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë "PETROL ALBA" SHA në likuidim"*

Bazuar në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve në shoqëri tregtare", ndryshuar me akte te tjera ligjore dhe të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me cilësinë e zotëruesit të 100% të aksioneve të shoqërisë "PETROL ALBA" SHA në cilësinë e aksionarit të vetëm:

**URDHËROJ:**

1. Kapitali themeltar të zvogëlohet për vlerën 23.408.000 lekë e barabarte me 23.408 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secili.
2. Kapitali themeltar i SHA "PETROL ALBA", Tiranë në likuidim, të bëhet nga 2,675,381,000 lekë në 2,651,973,000 lekë e barabartë me 2,651,973 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secili.
3. Ngarkohet likuidatori i shoqërisë, për kryerjen e veprimeve përkatëse në përputhje me parashikimet e Ligjit 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", seksioni III.
4. Ngarkohet shoqëria për zbatimin e këtij urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**ARBEN AHMETAJ**

**MINISTËR**

No. 20 Prot
/A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

# URDHËR

*Nr 73 5/1 Datë 12 - 1. 2016*

*Për përgatitjen e dokumentacionit për zvogëlimin e kapitalit themeltar të "PETROL ALBA" SHA në likuidim*

Bazuar në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve në shoqëri tregtare", ndryshuar me akte të tjera ligjore dhe të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me cilësinë e zotëruesit të 100% të aksioneve të shoqërisë "PETROL ALBA" SHA në likuidim

**URDHËROJ:**

1. Përgatitjen e dokumentacionit për zvogëlimin e kapitalit themeltar të "PETROL ALBA", SHA në likuidim, Tiranë për vlerën e objektit "TEC Tirana", Tiranë.
2. Ekspertja Kontabël e Autorizuar Zj. Vullnetare Çela të përgatisë raportin përkatës për ndryshimin e kapitalit themeltar në përputhje me pikën 1 të këtij urdhri.
3. Ngarkohet likuidatori i shoqërisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë .

**ARBEN AHMETAJ**

**MINISTËR**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK TURIZMIT TREGTISË DHE SIPËRMARRJES SEKRETARIA TIRANË